



Rr. Bahar Mois nr.4
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë

+389 (0) 2 3209 905

+389 (0) 2 3209 906

ndcskopje@ndc.net.mk
www.ndc.net.mk





PROGRAME VJETORE

PËR AKTIVITETE TË INTEGRUARA JASHTËMËSIMORE

(për klasën e shtatë, tetë dhe nëntë të arsimit fillor)

Qendra për Dialog Nansen Shkup

Programet janë të hartuara nga ana e Ekipit për edukim, trajnim dhe zhvillim pranë Qendrës për Dialog Nansen Shkup

Shkup, janar 2014

Lektore: Radife Mustafai

Programet janë financiarisht të përkrahura na Ministria e punëve të jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë

Përmbajtja:



RECENSIONE TË BAZAVE PROGRAMORE 4-12

të modelit Nansen për arsimim të integruar



KLASA E SHTATË 14-34

Programe vjetore për aktivitete të integruara jashtëmësimore për arsimin fillor

- Hyrje 15
- Arsimim për paqe dhe tolerancë (I)..... 17
- Eko- seksioni 23
- Seksioni muzikor 29



KLASA E TETË 36-56

Programe vjetore për aktivitete të integruara jashtëmësimore për arsimin fillor

- Hyrje 37
- Arsimim për paqe dhe tolerancë (II) 39
- Klubi sportiv Nansen 45
- Seksioni mediatiko- skenik 51



KLASA E NËNTË 58-76

Programe vjetore për aktivitete të integruara jashtëmësimore për arsimin fillor

- Hyrje 59
- Seksioni: Klubi i logjikuesve 61
- Seksioni: Popujt e botës 67
- Seksioni: Hulumtoj dhe zbuloj 73

Recensione të bazave programore

të modelit Nansen për arsimim të integruar

Prof. d-r. Zoran Velkovski

Univesiteti “Shën Kirili dhe Metodi” Shkup
Fakulteti filozofik
Instituti i pedagogjisë

Modeli Nansen për arsimim të integruar, në fokusin e tij i ka nxënësit të cilët i përkasin bashkësive të ndryshme etnike, nga arsimit fillor dhe i mesëm të cilët mësojnë në shkolla të përziera etnike. Hapësira në të cilën realizohet i takon pjesës së aktiviteteve jashtëmësimore në suaza të kurrikulës shkollore. Ajo supozon një dizajn të ri të mësimdhënies dhe mësimin dhe inkuadron në organizim të ri në punën e shkollës në të cilën janë të inkuadruar nxënësit, pjesëtar të bashkësive të ndryshme etnike. Në mungesë të mekanizmave integruar në procesin e rregullt arsimor, për shkak të ndarjes së nxënësve nga bashkësitë e ndryshme etnike, programi ka në rol të rëndësishëm kompenzues dhe promovon jo vetëm integrimin e nxënësve, por dhe integrimin e kuadrit arsimor nga prejardhja e ndryshme etnike në suaza të aktiviteteve jashtëmësimore brenda shkollës.

Zhvillimi i dialogut ndërkulturor mes nxënësve dhe mes mësimdhënësve paraqet platformën themelore në të cilën bazohet modeli Nansen për arsimim të integruar.

Modeli Nansen për arsimim të integruar i Qendrës për dialog Nansen Shkup etablohet si tejet kualitativ dhe për gjendjet në shtet, është model adekuat për përfundimin e dialogut ndërkulturor mes nxënësve me prejardhje të ndryshme etnike, kulturore dhe fetare. Ky model ka ndikim të madh në nxënësit dhe mësimdhënësit po ashtu edhe në shkollat dhe rrethin më të gjerë. Modeli është origjinal për rrethinat në të cilat realizohet dhe paraqet iniciativë e cila plotësisht korrespondon me prioritetet shtetërore në fushën

e arsimit. Programi realizohet në vende të cilat karakterizohen me strukturë multietnike të banorëve. Karakteristika themelore e këtyre vendeve është ndarja etnike e cila pas konflikteve të vitit 2001 është përfunduar dhe paraqet një faktor të fortë për ndarjen e nxënësve sipas bazave etnike jo vetëm jashtë shkollës, por edhe brenda saj. Në kushte të mbylljes së shprehur të të rinjve dhe të rriturve brenda vlerave personale kulturore, programi tenton të realizojë një model i cili do të jetë në funksion të përfundimit të dialogut ndërkulturor.

Procesi arsimor është i organizuar në mënyrë që përmbajtjet e karakterit jashtëmësimit janë vënë në korrelacion me programet mësimore të karakterit obligues dhe janë në funksion të plotësisht të tyre. Pas përfundimit të mësimin të rregullt (i cili realizohet në gjuhën amë të nxënësve), realizohen aktivitetet jashtëmësimore për të gjithë nxënësit në nivel të klasave. Në përmbajtjet dominon konteksti multi-etnik i cili ka për qëllim që përveç njohurive, tek nxënësit të zhvillojë ndjenjën dhe qëndrimet ndaj kulturës “tjetër” dhe vlerave të saj. Qasja është pa imponime, me fare pak kërkesa për memorime dhe i shkarkon nxënësit nga “obligimi” për mësim të obligueshëm.

Aplikimi i metodave interaktive gjatë punës me nxënësit është komponentë e domosdoshme për realizimin e programit. Me grupet e nxënësve me prejardhje të ndryshme etnike punon tandem i mësimdhënësve të cilët paralelisht e realizojnë mësimin në gjuhën e tyre amtare, përkatëse për një pjesë të nxënësve. Kompo-

nenti dygjuhësor është shtylla kryesore në të cilën mbështeten aktivitetet e programeve. Mësimdhënësit janë të inkuadruar si tandemë në formësimin e përmbajtjeve jashtëmësimore, gjë që është platformë për proceset integruese në suaza të shkollës. Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimdhënësi flasin në gjuhën e tyre amtare, me atë që nuk përkthejnë njëri tjetrin por i parafrazojnë pyetjet, sqarimet, sugjerimet. Gjatë kësaj, të gjithë nxënësit mund të përcjellin arsimin në të dyja gjuhët paralelisht me çka krijohet baza për pasurimin e fjalorit të tyre me fjalë nga gjuha “tjetër”. Mësimi i gjuhës “tjetër” është efekt sporadik i cili del nga qëllimi bazik i programit- sensibilizimi për dallimin e ndryshimeve dhe mesazhi i drejtpërdrejtë që dy gjëra të ndryshme mund të funksionojnë si një tërësi.

Në punën me nxënësit, dominon forma grupore e punës arsimore e kombinuar me aktivitete të lojës me çka ofrohet mundësia për bashkëpunim të afërt mes nxënësve të bashkësive të ndryshme etnike gjatë realizimit të aktiviteteve gjatë mësimin. Rëndësia e mësimin është përqëndruar në njohuritë të cilat derivohen nga eksperiencia e nxënësve dhe rrethinës, dhe shpesh janë të lidhura me atë që nxënësit e mësojnë gjatë mësimin të rregullt. Nga nxënësit kërkohet që të mendojnë logjikisht dhe të zhvillojnë fleksibilitet ndaj dukurive me tendencë të shprehur për zhvillimin e mendimit kritik dhe divergjent tek nxënësit.

Modeli Nansen për arsimim të integruar ka një ndikim të fuqishëm mbi përforcimin e kompetencave personale dhe shoqëro-

re të nxënësve, ndaj ndërtimit të shkathtësive dhe qëndrimeve për tolerancë, bashkëpunim të ndërsjellë dhe mirëkuptim. Roli i modelit është i fuqishëm në hapësirën e aktiviteteve jashtëmësimore, ndërsa rezultatet dëshmojnë që është një model i cili me lehtësi mund të zhvillohet në një model shtetëror për fuqizimin e dialogut ndërkulturor në sferën e arsimimit dhe më gjerë.

Prof. d-r. Avzi Mustafa

Fakulteti filologjik "Bllazhe Koneski", Shkup

Ky projekt, si model i cili aplikohet në sistemin arsimor si një tentativë gjithëpërfshirëse për reforma shkollore, është para së gjithave mjaft interesant. Projekti është i njohur si model për aktivitete të integruara jashtëmësimore të cilat realizohen në suaza të shkollave të mesme dhe fillore dhe njihet si: modeli Nansen për arsimim të integruar, ndërsa implementohet nga ana e Qendrës për dialog Nansen Shkup, i përkrahur gjithashtu nga Ministria e arsimit dhe shkencës së R. së Maqedonisë.

Mendimi im për këtë projekt përfshin një rezime të vlerësimit, e realizuar në fazën e parë të projektit, si dhe vlerësimi i fazave tjera të derivuara nga eksperiencia personale dhe programet e implementuara. Ky vlerësim, në esencë reflekton mendimin tim personal si një mbikëqyrës i pavarur dhe si njeri i cili merret me tentativat reformuese në R. e Maqedonisë, ndërsa bazohet në dokumentacionin e ofruar dhe programeve mësimore nga ana e anëtarëve, respektivisht peronave përgjegjës për implementimin e Programit të modelit Nansen për arsimim të integruar dygjuhësor. Duke u nisur nga qëllimi i dhënë, MNAI është një kombinim i ri i metodologjisë së organizimit dhe mësimdhënies në grupe me përbërje të ndryshme etnike, me një filozofi të re të përfshirjes së nxënësve prej ambienteve të ndryshme etnike. Ky projekt në Maqedoni realizohet me organizimin e aktiviteteve të cilat nxënësit mund ti realizojnë në kohën e aktiviteteve të lira shkollore në suaza të shkollave të cilat janë të inkuadruara në implementimin e këtij modeli.

Pas pesë viteve, mund lirisht të thuhet se projekti ka një ndikim të shprehur pozitiv jo vetëm tek përkrahësit dhe partnerët e pro-

jektit, po edhe tek shumica e nxënësve, prindërve dhe shkollës të cilët sot, me krenari i theksojnë vlerat dhe leverditë nga ky model tejet interesant në shoqëritë multietnike, siç është dhe e jona. Modeli për arsimim të integruar dhe dygjuhësor nuk është interesant vetëm si model ose risi e ndonjë reforme shkollore, por para se gjithash është i rëndësishëm dhe interesant sepse në plan të parë ofron një segment të veprimtarisë së ndërlikuar edukative, veçanërisht kur gjendemi në një periudhë dhe gjendje suptile ekonomike, sociale dhe etnike. Me anë të këtij modeli mundësohet kultivimi i shprehive pozitive në zgjedhjen e problemeve, dhe ajo të realizohet përmes aktiviteteve të cilat realizohen përmes lojës dhe me kyqjen e sekcioneve të ndryshme, nga të cilat vjen deri tek ngritja e nivelit të tolerancës, përmirësimit të vetëvlerësimit, si dhe treguesve subjektiv në zhvillimin e shkathtësive jetësore përmes përmbytjeve të pasura, të cilat janë ngushtë të integruara me përmbytjet e karakterit të obligueshëm dhe formal.

Me ndihmën e këtij modeli mundësohet kultivimi i shprehive pozitive gjatë zgjedhjes së problemeve, dhe ajo të bëhet përmes aktiviteteve të përbashkëta të cilat realizohen përmes lojës dhe me inkuadrimitin e sekcioneve të ndryshme, me ndihmën e të cilave vjen deri tek ngritja e nivelit të tolerancës, përmirësimin e vetëvlerësimit, si dhe treguesve subjektiv në zhvillimin e shkathtësive jetësore përmes përmbytjeve të pasura të cilat janë ngushtë të integruara me përmbytjet e karakterit formal dhe të obligueshëm. Ky model, i implementuar në vendet me strukturë etnike heterogjene ka për qëllim të përmirësojë shkathtësitë jetësore përmes aktiviteteve jashtëmësimore të pa obligueshme.

Të rinjtë, përmes modelit Nansen, kanë mundësi të madhe të zhvillojnë dhe përforcojnë në mënyrë spontane interaksionin jo vetëm mes nxënësve, por dhe në relacionin nxënësit- profesorë-prindër. Të gjitha aktivitetet e planifikuara, përmes këtij modeli ofrojnë mundësi për mësimdhënësit dhe nxënësit së bashku të planifikojnë dhe përgatisin aktivitete dygjuhësore, së bashku të organizojnë trajnim për aplikimin e veprimeve didaktiko-metodike, etj. Me ndihmën e projektit, në interes të nxënësve, pa imponime, planifikohen tema interesante, ndërsa puna realizohet në grupe, në të cilat ato shoqërohen dhe në mënyrë spontane socializohen dhe edukohen, që të mundën të jetojnë lirë pa paragjykim ndaj tjerëve në një shoqëri shumë gjuhësore dhe shumë profesionale, në bashkëjetesë dhe bashkësi.

Modeli ofron një mundësi të madhe për sensibilizimin e klimës pozitive dhe bashkëpunimit jo vetëm mes nxënësve, por mes arsimtarëve dhe prindërve gjithashtu. Në të gjitha shkollat e arsimit të mesëm dhe fillor, modeli ofron një frymë të re, e freskon dhe jetën shkollare të fëmijëve, ndërsa shkolla fiton një dinamikë të re. Përmes këtij modeli, shkolla luan rolin e katalizatorit të veprimtarisë ndërkulturore, gjithashtu vjen në shprehje dhe motivacioni tek fëmijët, zhvillimi i dialogut ndërkulturore, kultivimi i principit të besimit të ndërsjellë, ofrimi i mundësisë për kontakt fizik mes nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike, aplikimi i dialogut në mënyrë të drejtëpërdrejtë, etj. Përmes punës kreative të cilat janë të konceptuara me përmbajtje stimuluese, motivuese, shtytëse dhe lojë të ndryshme, të organizuara në programet për nxënësit: të artit, dramës, trafikut, eko-sekcionit etj., sekcionet ofrojnë mundësi të madhe për kyqje aktive të nxënësve në krijimin, në pajtim me interesat, aftësitë, njohuritë e mëparshme si dhe talentet e nxënësve, njëkohësisht këto programe ofrojnë hapsirë për fëmijët me nevoja të posaçme, për socializimin dhe ndjenjën e barazisë me nxënësit tjerë.

Njëkohësisht, programet nga ky model kontribuojnë në rritjen e nivelit të njohurisë tek nxënësit me sukses më të dobët, me qëllim të realizimit të qëllimeve lëndore. Nxënësit, përmes aktiviteteve të lira, kontribuojnë në njohjen e gjuhës dhe kulturës së tjerëve, duke i potencuar ngjashmëritë dhe dallimet mes nxënësve. Mësimdhënësit me këtë model e tejkalojnë rolin e tyre tradicional në vendet e punës dhe e ndërmarrin rolin e lehtësuesve dhe mo-

shatarëve, dhe jo vetëm ligjërues të cilët vetëm përcjellin informacione. Mësimdhënësit janë të vetëdijshëm që ky model ju merr më shumë kohë në krahasim me atë të zakonshmin, por janë po ashtu të vetëdijshëm se aplikimi i kësaj metode ka më shumë efekte që të mbahen nxënësit e angazhuar gjatë procesit të nxënies.

Nga programet qartë shihet se hartuesit si dhe arsimtarët të cilët do ti aplikojnë këto programe i kanë konceptuar në bashkëpunim me nxënësit, kështu që, të gjitha programet për të gjitha klasat janë tejet interesante dhe të pëlqyera nga nxënësit.

Gjatë zgjedhjes së përmbajtjeve, gjithmonë pikënisja ka qenë principi i qasjes sipas aftësive psikofizike të nxënësit, aktualiteti dhe atraktiviteti. Në përmbajtjet të cilat realizohen përmes elementeve të lojës në gjuhën amtare dhe përmes parafrazimit të njërës apo tjetrës gjuhë, në mënyrë spontane zbulohen dallimet dhe ngjashmëritë, me ç'rast, gjatë një ore mësimore ose gjatë organizimit të aktiviteteve të ndryshme jashtëmësimore, gradualisht njihen me dy gjuhët, dhe atë e bëjnë përmes formave të ndryshme të organizuara, gjegjësisht përmes sekcioneve të ndryshme. Në përgjithësi, programet e këtij modeli të aktiviteteve jashtëmësimore, gjatë realizimit të qëllimeve dëshmojnë si shumë efektive në përmbushjen e parashikimeve të parashtruara. Nga gjithë ajo e cila është e treguar në punën e deritanishme të këtij projekti, mund të konstatohet se ai duhet përkrahur fuqimisht nga të gjithë faktorët, siç janë; drejtorët, Ministria, institucionet tjera dhe pushteti lokal, duke ofruar përkrahje në drejtim të aplikimit të programeve të tilla dhe përfitimin e leverdive nga efekti i tyre si dhe integrimin e tyre në reformat e përgjithshme të kurrikulave.

Ilija Leshkovski

ish këshilltar

Byroja për zhvillimin e arsimit të R. Së Maqedonisë

Zgjedhjet didaktiko-metodike të propozuara në programet vjetore për aktivitete të integruara jashtëmësimore nga klasa e I gjer në klasën e IX në arsimin fillor dhe nga viti i I gjer në vitin e IV në arsimin e mesëm, paraqesin një tentativë të parë në praktikën edukativo-arsimore që brenda një tërësie bashkuese në mënyrë segmentuese të barten përmbajtje për aktivitetet jashtëmësimore.

Përmbajtjet e integruara të cilat janë të ofruara mundësojnë kultivimin e klimës pozitive socio-emocionale në grupin me përbërje etnike heterogjene, si dhe bashkëpunimin konstruktiv ekipor dhe tandemi mes nxënësve.

Pikëpamjet bashkëkohore të proceseve për aktivitete të integruara jashtëmësimore përcillen nga segmentet e programeve, përmbajtjeve dhe zgjedhjeve metodike. Në kuptimin metodik, përmbajtjet posedojnë vlera edukative të cilat mundësojnë realizimin e qëllimeve nga fushat e ndyshme programore.

Integrimi programor i aktiviteteve jashtëmësimore paraqet një sfidë metodike për mësimdhënësin dhe nxënësin për shkak se mundësojnë qasje dygjuhësore në relizimin e përmbajtjeve me nxënës të përkatësive të ndyshme etnike.

Përveç elementeve të domosdoshme njohëse dhe metodike, programet ofrojnë spektër të gjërë të aktiviteteve stimuluese, motivuese, shtytëse dhe të lojës të cilat janë në funksion të përfuturit të kulturës së përgjithshme tek nxënësit.

Aktivitetet e përgjithshme, në të gjitha fazat janë të radhitura dhe të kahëzuara në funksion të aftësimin për bashkëjetesë, shoqërim dhe respektim të diferencave si dhe pasurim të fjalorit elementar me nocione dhe fraza shoqëro-kulturore nga gjuha folëse e bashkësisë tjetër etnike.

Përmbajtjet e ofruara ofrojnë mundësi të shumëfishta për realizimin e programeve për aktivitete të integruara jashtëmësimore.

Mësimdhënësit mund të kultivojnë qasjen kritike dhe fleksibile ndaj përmbajtjeve të ofruara, të gjejnë rrugën e tyre për realizimin i cili do të jetë i adaptuar dhe i formësuar nga kushtet konkrete të punës me mundësinë që individualisht të zgjedhin 2-3 sekcione nga të ofruarat në suaza të programit vjetor.

Aktivitete të theksuara të cilat ofrohen nga programet e integruara jashtëmësimore janë:

- *Zhvillimi i aftësive të nxënësve për të kuptuar, informuar dhe për tu shprehur në gjuhën e komunitetit tjetër etnik;*
- *Përdorimi i më shumë burimeve të njohurive;*
- *Përqendrim ndaj prindërve dhe të rriturve;*
- *Bashkëpunim ndëretnik dhe ndërkulturor;*
- *Bashkëpunim i theksuar mes nxënësve dhe kuadrit arsimor.*

Në bazë të analizës kritike të funksionalitetit të përgjithshëm edukativo- arsimor dhe didaktiko- metodik të programeve vjetore për aktivitete të integruara jashtëmësimore, mund të konkludohet se janë të ofruara programe të cilat janë të përshtatshme për organizimin dhe realizimin e aktivitetit jashtëmësimor kualitativ në arsimin fillor dhe të mesëm. Kualiteti i veçantë i programeve është qasja dygjuhësore gjatë realizimit, e pranishme çdo ditë gjatë implementimit të aktiviteteve me nxënësit nga paralelet maqedonase, shqiptare, turke dhe serbe. Përmes sekcioneve të ofruara, fushave tematike dhe përmbajtjeve, mund të realizohet hyrje kualitative dhe e plotësuar e nxënësve në aspekte të ndryshme edukativo- arsimore, respektivisht, përgatitja e nxënësve për bashkëjetesë, mirëkuptim të ndërsjellë, respekt, ndihmë, paqe dhe tolerancë, dhe jetesë kualitative në bashkësi.

Programet përmes përmbajtjeve të ofruara mundësojnë kultivimin e marrëdhënieve ndërkulturore në realitetin multikulturor, kryesisht përmes komunikimit dhe mësimin të gjuhëve si dhe njoftimin me kulturën dhe religjionin e bashkësive tjera etnike.

Tejet me rëndësi është që këto modele të programimit, planifikimit, organizimit dhe realizimit korrespondojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me tendencat bashkëkohore për edukim dhe arsimim tek ne dhe në botë.

Aktualiteti i zgjidhjeve didaktiko- metodike të programeve për planifikim jashtëmësimor të integruar do të kontribuojë që

mësimdhënësit ti pranojnë programet si nevojë, gjithashtu si një material konstruktiv për realizimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve jashtëmësimore.

Nga këto arsye, me kënaqësi të veçantë sugjeroj që këto programe vjetore të pranohen nga ana e mësimdhënësve si një mjet i dobishëm për planifikim dhe realizim të aktiviteteve jashtëmësimore në arsimin fillor dhe të mesëm.

Gjonyl Bajraktar

Ish drejtor i SHF "Tefejuz"- Shkup

Sistemi arsimor në R. e Maqedonisë gjatë viteve të fundit ka bërë përpjekje të mëdha për promovimin e arsimit të integruar, posaçërisht në inkuadrimin e nxënësve nga bashkësitë e ndryshme etnike në procesin. Qëllimi i modelit arsimor (modelit Nansen për arsimim të integruar) është që të kultivojë, inkurajojë dhe integrojë vlerat multietnike, respektimin e dallimeve, të drejtave dhe detyrimeve në shoqërinë multietnike, përmirësimin dhe zhvillimin e komunikimit të ndërsjellë si dhe krijimin e klimës pozitive emocionale në shkollat dhe shoqërinë.

Për organizimin e aktiviteteve të integruara jashtëmësimore dygjuhësore, në suaza të programeve të modelit Nansen për arsimim të integruar për arsimin fillor dhe të mesëm janë të përfshira të gjitha qëllimet globale. Selektimi i tre temave në programet vjetore është bërë në mënyrë profesionale. Gjatë selektimit është marr parasysh zhvillimi psikofizik i fëmijëve si dhe përmbajtjet e temave dhe aktiviteteve që janë pklaniifikuar për nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike. Në suaza të aktiviteteve, fëmijët bashkëpunojnë mes veti, komunikojnë, respektohen, dhe në të njëjtën kohë i tejkalojnë stereotipat dhe paragjykimet ndaj të tjerëve.

Gjatë realizimit të këtij programi zhvillohet klimë pozitive në ambientin, ndërsa në atë mënyrë zmadhohet interaksioni dhe bashkëpunimi mes nxënësve, mësimeve dhe prindërve. Dukuria e cila është tejet me rëndësi dhe duhet theksuar është shprehja e interesimit për mësimin e gjuhës së tjetrit, si dhe interesimi për kulturat dhe traditat e ndryshme. Nuk duhet anashkaluar dhe qël-

limet të cilat ndikojnë mbi zhvillimin e talentit fëmijëror, kuriozitetit, logjikës, fantazisë, mendimit kritik si dhe individualitetin e fëmijës.

Organizimi bashkëkohor i arsimit duhet ngadalë të braktis sistemin shkollor të përcjelljes së njohurive të gatshme dhe riprodhimit të tyre. Arsimi duhet të begatohet me forma të reja organizative dhe veprime metodike të cilat zhvillojnë mendimin produktiv dhe krijues tek nxënësit. Sipas modelit Nansen për arsimim të integruar dhe aktiviteteve të integruara, me rëndësi është të përmendet se mësimeve janë të përgatitur për ndryshime dhe për revizimin e rolit të tyre për shkak se ata janë në rolin e udhëzuesve, motivuesve, animatorëve, vlerësuesve, bashkëpunëtorëve, etj.

Gjithashtu, nxënësi nuk duhet të merr njohuri të gatshme, por duhet të arrijë tek ato në bazë të veprimeve të caktuara motivuese. Për këtë arsye nxënësi duhet aftësuar për mësim të pavarur dhe detyrat ti pranojë si punë individuale. Me ato veprime, nxënësi jo vetëm që aftësohet për punë individuale por gjithashtu shfrytëzon mundësinë që të shprehet si kreator dhe krijimtar. Me këtë do të arrihet një nga detyrave themelore të arsimit fillor dhe të mesëm që "te nxënësit të zhvillohet pavarësia dhe kreativiteti dhe të pasurohet interesi për përfitim të njohurive dhe shkathtësive të reja për mësim".

Sipas kësaj, qëllimet e hartuara, detyrat dhe aktivitetet në suaza të programit për aktivitete të integruara jashtëmësimore

sipas MNAI, këtë model e bën të dallohet nga arsimi i rregullt, respektivisht i obligueshëm. Arsimimi është proces i përfitimit të njohurive, shkathtësive dhe shprehive, formësimin e pikëpamjeve ndaj botës dhe zhvillim psikofizik të nxënësve. Jemi të vetëdijshëm se nxënësit janë të rrethuar me media. Për këtë shkak, është shumë vështirë që një mësimitdhënës të ligjërojë dhe të sqarojë njësi mësimore e cila do ti mbajë të përqendruar të gjithë në një hapësirë.

Në këtë mund të kenë sukses vetëm në rast se përgatit një skenar aktiv didaktik në të cilën dëgjuesit do të jenë pjesëmarrës aktiv, do të kërkojnë informacione, do ti formojnë dhe zbatojnë informatat e zbuluara, do ti zgjidhin problemet, do të hulumtojnë, zbulojnë, etj. QDN Shkup e arrin këtë në mënyrë profesionale përmes programeve të organizuara për aktivitete të integruara jashtëmësimore sipas MNAI.

Veçanërisht duhet të theksohet dhe të inkurajohet inkuadrimi i mësimitdhënësve adekuat nga bashkësitë e ndryshme etnike, sepse në këtë mënyrë zmadhohet komunikimi dhe bashkëpunim mes tyre, gjithashtu zhvillohet dhe bashkëpunimi mes prindërve nga bashkësitë e ndryshme etnike.

Ideja për përgatitjen e prezantimeve përfundimtare (ekspozita, shfaqje, gara) paraqet komponentë pozitive në tërë procesin, ku munda i investuar dhe puna e nxënësve është tejet e rëndësishme për promovimin e arsimimit të integruar. Inkuadrimi i nxënësve

nga grupet e ndryshme etnike, si dhe mësimitdhënësve, prindërve dhe bashkësitë lokale, përbën të gjitha hallkat e rëndësishme të zinxhirit të procesit arsimor, veçanërisht duhet pasur kujdes që secila hallkë të gjejë vendin e vet në procesin e integritit.

Nga eksperiencia ime e deritanishme në fushën e arsimimit, mundem ti inkurajoj dhe ti përkrah këto tentativa për aktivitete të integruara jashtëmësimore, me qëllim që në të ardhmen të kemi gjenerata të cilat do të respektohen, dhe përkrah dallimeve të mëdha të ndërtojnë një shoqëri mutietnike.



